

KUJDES! MOS DËMTO BARKODIN

BARKODI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SHKENCËS
AGJENCIA QENDRORE E VLERËSIMIT TË ARRITJEVE TË NXËNËSVE

PROVIMI I MATURËS SHTETËRORE 2009

SESIONI I

(I DETYRUAR)

VARIANTI B

E martë, 2 qershor 2009

Ora 10.00

Lënda: Letërsi dhe Gjuhë shqipe
Shkolla e mesme pedagogjike

Udhëzime për nxënësin

Testi është i ndarë në dy pjesë: në gjuhë shqipe dhe në letërsi.

Testi në total ka **25 pyetje**.

Në të dy pjesët ka kërkesa me **zgjedhje** dhe me **zhvillim**. Në kërkesat me zgjedhje rrethoni **vetëm** shkronjën përbri përgjigjes së saktë, ndërsa për kërkesat me zhvillim është dhënë hapësira e nevojshme për të shkruar përgjigjen.

Koha për zhvillimin e kërkesave të testit është **2 orë e 30 minuta**.

Pikët për secilën kërkesë janë dhënë përbri saj.

Për përdorim nga komisioni i vlerësimit

Kërkesa	1	2	3	4	5	6	7	8a	8b	9a	9b	9c	9d	10a
Pikët														
Kërkesa	10b	10c	11a	11b	12a	12b	12c	13	14	15	16	17	18	19a
Pikët														
Kërkesa	19b	20a	20b	21	22a	22b	23	24	25a	25b	25c	25d		
Pikët														

Totali i pikëve

KOMISIONI I VLERËSIMIT

1.....Anëtar

2.....Anëtar

PJESA I**Gjuhë shqipe**

Xhadeja zbriste e zbriste poshtë duke gjarpëruar e duke u mbledhur kular rreth maleve...

Herë pas here, tek zbrisnin, gjenerali kthente kokën pas. Malet po largoheshin gjithmonë e më tepër. Konturet e tyre bëheshin më abstrakte, më pak kërcënuese. Gjenerali i vështronte me një mënyrë të tillë sikur t'u thoshte: "Tani mbaroi presioni juaj. Ju ika, ju ika." Pastaj, në orët e dremitjes në makinë, befas e zinte një frikë e turbullt. I dukej sikur malet do të zgjatnin dorën e tyre të akullt për ta kthyer përsëri atje në grykat e tyre.

Por ai s'do të kthehej më kurrë atje. Kurrë.

Zbritën në një fshat të madh bashkë me mbrëmjen. Ishte hera e parë gjatë dhjetë ditëve, që gjeneralit i qeshi buza. Më në fund mbaroi. Atë natë do të flinin aty dhe të nesërmen në mëngjes do të niseshin për në Tiranë. Dhe pas disa ditësh në atdhe. Gjenerali ishte në qejf. Një valë e vakët gëzimi, megjithëse akoma e ndrojtur, po përpiquej ta pushtonte.

Në fshat akoma nuk ishin ndezur dritat. Vetura kaloi nëpër udhën me baltë, midis fshatit, e ndjekur nga një turmë kalamajsh. Përpara klubit të kooperativës shoferi nxori kokën nga dera e përparme dhe pyeti ku ndodhej kryesia e kooperativës. Kalamajtë ia treguan me të bërtitura dhe, pa e bërë të gjatë, një pjesë e tyre u nis me vrap përpara për të treguar vendin më saktë, kurse të tjerët iu vunë pas dhe vetura ecte tani ngadalë midis kalamajve që bënin zhurmë e bërtisnin me zërat e tyre të hollë e të lartë.

Vala e gëzimit po bëhej më e ngrohtë dhe pasiguria po shpërbëhej.

Fragment nga romani i Kadaresë
"Gjenerali i ushtrisë së vdekur"

Për pyetjet 1-7 rrethoni **vetëm** shkronjën që i përgjigjet alternativës së saktë.

1. Qarkoni alternativën që ka një fjalë të shkruar gabim.

1 pikë

- A) Të sapoardhurit po zhvendosnin mobiliet e vjetra.
- B) Asnjë shmangie nuk u vu re në zbatimin e detyrës.
- C) Të gjithë i quajtën "tradhti të ulëta" sjelljet e tij.
- D) Në trekëndëshin këndrejtë ka dy brinjë pingule.

2. Në ndërtimin: *Ju ika, ju ika*, fjala *ju* është:

1 pikë

- A) përemër vetor
- B) përemër dëftor
- C) pjesëz
- D) trajtë e shkurtër e përemrit vetor

3. Fjala *shpërbëhej* është formuar:
- 1 pikë
- A) me prejardhje me prapashtesë
 B) me prejardhje me parashtesë e prapashtesë njëkohësisht
 C) me prejardhje me parashtesë
 D) me përngjitje
4. Qarkoni fjalën e urtë:
- 1 pikë
- A) Fëmijët u nisën pa e bërë të gjatë.
 B) Nuk bëhet stan me lepuj.
 C) Mëso t'u bësh ballë vetë të gjitha vështirësive.
 D) Nëna u bë me krahë nga gëzimi.
5. Në fjalinë: “*I dukej sikur malet do të zgjatnin dorën për ta kthyer përsëri aty...*” folja *do të zgjatnin* është:
- 1 pikë
- A) në kohën e ardhme, mënyra dëftore
 B) në kohën e ardhme të përparme, mënyra dëftore
 C) në kohën e tashme, mënyra kushtore
 D) në kohën e ardhme të së shkuarës, mënyra dëftore
6. Në fjalinë: “*Konturet e tyre bëheshin më abstrakte, më pak kërcënuese*”, fjala e nënvizuar është:
- 1 pikë
- A) përcaktor kallëzuesor i shprehur me mbiemër
 B) rrethanor mënyre i shprehur me mbiemër
 C) përcaktor kallëzuesor i shprehur me emër
 D) rrethanor mënyre i shprehur me emër
7. Fjalja: “*Iu krijua përshtypja sikur malet do të zgjatnin dorën e tyre të akullt për ta kthyer përsëri atje në grykat e tyre.*” është:
- 1 pikë
- A) fjali e përbërë me më shumë se dy pjesë
 B) fjali e përbërë përcaktore
 C) fjali e përbërë ftilluese kryefjalore
 D) fjali e përbërë qëllimore
8. Gjeni rasën e emrit të nënvizuar në fjalinë e mëposhtme dhe tregoni funksionin sintaksor të tij.
Një valë e vakët gëzimi po përpiquej ta pushtonte.
- a) rasa: _____ 1 pikë
- b) funksioni: _____ 1 pikë

9. Përcaktoni klasën e fjalëve të nënvizuara në fjalitë e mëposhtme.

Herë pas here, tek zbrisnin, gjenerali kthente kokën pas. Malet po largoheshin...

Konturet e tyre bëheshin më abstrakte, më pak kërcënuese.

Vetura kaloi nëpër udhën me baltë.

- | | | | |
|----------------|-------|---------------|----------------------|
| a) tek: | _____ | 1 pikë | <input type="text"/> |
| b) pas: | _____ | 1 pikë | <input type="text"/> |
| c) kërcënuese: | _____ | 1 pikë | <input type="text"/> |
| d) nëpër: | _____ | 1 pikë | <input type="text"/> |

10. Nënvizoni pjesën kryesore në fjalinë mëposhtme, tregoni llojin e saj dhe mjetin lidhës të pjesëve.

- | | | |
|--|---------------|----------------------|
| a) <i>Një valë e vakët gëzimi, megjithëse në fillim dukej e ndrojtur, po e pushtonte dalëngadalë të tërin.</i> | 1 pikë | <input type="text"/> |
| b) lloji i fjalisë: _____ | 1 pikë | <input type="text"/> |
| c) mjeti lidhës: _____ | 1 pikë | <input type="text"/> |

11. Gjeni kallëzuesin në fjalinë e mëposhtme dhe tregoni llojin e tij.

Xhadeja zbriste e zbriste poshtë duke gjarpëruar dhe duke u mbledhur kular rreth maleve.

- | | | |
|----------------------|---------------|----------------------|
| a) kallëzuesi: _____ | 1 pikë | <input type="text"/> |
| b) lloji: _____ | 1 pikë | <input type="text"/> |

12. Përcaktoni llojin e rrethanorit të nënvizuar në fjalinë e mëposhtme. Tregoni me se është shprehur dhe nga varet ai.

Kalamajtë ia treguan me të bërtitura dhe, pa e bërë të gjatë, një pjesë e tyre u nis me vrap përpara për të treguar vendin më saktë, kurse të tjerët iu vunë pas...

- | | | |
|-----------------------|---------------|----------------------|
| a) rrethanori: _____ | 1 pikë | <input type="text"/> |
| b) shprehur me: _____ | 1 pikë | <input type="text"/> |
| c) varur nga: _____ | 1 pikë | <input type="text"/> |

PJESA II**ESKILI****Koeforet (fragment)****KLITEMNESTRA**

Ç'ke që thërret, që ngre shtëpinë në këmbë?

SHËRBËTORI

Të vdekurit u ngritën e vranë të gjallët.

KLITEMNESTRA

O tmerr! E mora vesh se ç' do të thuash:
Siç vramë me dredhi, ashtu do të vritemi!
Më jepni shpejt pra shpatën me dy presa,
Të shohim do të vras, a do të më vrasin,
Meqenëse gjer këtu më solli i trishti fat.

*(Ajo drejtohet nga porta qendrore që hapet
befas. Prej saj del Oresti me shpatë në dorë.
Piladi është pas tij. Shërbëtori ikën me vrap)*

ORESTI

Ty të kërkoj. Se ky e lau hesapin.

KLITEMNESTRA

Mjera unë, Egisti im, të vranë, i dashur!

ORESTI

E do akoma? Pranë tij pra shko.
Në varr përbri e vdekur rri besnike.

*(Ngre shpatën, Klitemnestra i bie në gjunjë
dhe zbulon gjirin.)*

KLITEMNESTRA

Ndalo, o bir, nderoje këtë gj
Përmbi të cilin gjumi shpesh të zu
Tek qumështin që ty të rriti, thithje.
(Oresti ul shpatën)

ORESTI

Ç' të bëj Pilad? A vritet vallë nëna?

PILADI

Harrove ç'parathënma bëri Febi,
Këshillën e Pitosë dhe betimet,
Dëgjomë, gjithë njerëzit mund t'i bësh
Armiq, por kurr' armiq mos bëj hyjnitë.

ORESTI

Ti ke të drejtë. Ty do të dëgjoj.
(Klitemnestrës)
Më ndiq, pranë tij unë dua të të ther.
Sa ishte gjallë, atë ti veç pëlqeve
Në vend të atit tim, ahëre shko

Me të edhe në vdekje. Është ai
Që deshe, një hero ndërsa urreje.

KLITEMNESTRA

Të kam ushqyer. Me ty dua të plakem.

ORESTI

Të rrosh me mua, vrasëse e babait?

KLITEMNESTRA

Kështu nga Fati që e shkruar, bir.

ORESTI

Nga Fati pra dhe fundi yt është shkruar.

KLITEMNESTRA

S'i trembesh, bir, mallkimit të një nëne?

ORESTI

Një nënë që në mjerim e flaku të birin.

KLITEMNESTRA

Të kam dërguar në shtëpi të miqve.

ORESTI

Dy herë më shite mua, një qytetar të lirë.

KLITEMNESTRA

Ç' fitim un' paskam pasur nga kjo shitje?

ORESTI

Kam turp të them fitimin e urreyer.

KLITEMNESTRA

E thuaj. Po dhe ati yt pat faj.

ORESTI

Mos përgojo heroin, ti që rrije
E shtrirë në shtëpi, ndërsa ai luftonte.

KLITEMNESTRA

Bir, gruaja larg burrit s'e ka të lehtë.

ORESTI

Me djersë të burrit në shtëpi ushqehet.

KLITEMNESTRA

Vërtet kërkon, o bir, të vrasësh nënën?

ORESTI

Nuk të vras unë, ti veten vetë ke vrarë.

KLITEMNESTRA

Hap sytë, se gjaku i nënës të zë rëndshëm.

ORESTI

Po gjakut të babait, që më thërret, ç't'i bëj?

KLITEMNESTRA

Ah, qenke shurdh si varri! Më kot lutem!

ORESTI

Fati tim eti të dënoi me vdekje.

KLITEMNESTRA

Një gjarpër paskam lindur e paskam rritur.

ORESTI

E kobshmja ëndërr e vërtetë po del.
Një burrë vrave, vdis pra nga një bir.
(E zvarrit nënën në pallat)

Për fatin e të dyve qaj tani.
Por meqë ky radhën e vrasjes mbylli
Me të është zemra ime dhe uroj
Që të mos shuhet kurrë syri i shtëpisë.

Për pyetjet 13-18 rrethoni **vetëm** shkronjën që i përgjigjet alternativës së saktë.

13. Oresti është kthyer nga mërgimi, sepse:

1 pikë

- A) do të ndajë Klitemnestrën nga Egisti.
- B) do të vizitojë varrin e të atit.
- C) do të marrë motrën me vete.
- D) do të marrë gjakun e babait.

14. Vargu “Të vdekurit u ngritën e vranë të gjallët” nënkupton:

1 pikë

- A) fantazmat janë ngritur e po hakmerren.
- B) perënditë janë kthyer për të vranë.
- C) në pallat ka plasur rrëmuja dhe vrasja.
- D) disa njerëz të panjohur po vrasin këdo që u del përpara.

15. Dialogu midis Orestit dhe Klitemnestrës karakterizohet nga fjali të shkurtra.
Arsyeja e këtij përdorimi është:

1 pikë

- A) rritja e tensionit dramatik.
- B) theksimi i karakterit të rrëmbyer të Orestit.
- C) shtimi i muzikalitetit të vargut.
- D) krijimi i përshtypjes së lojës së fjalëve.

16. Në cilën prej alternativave të mëposhtme shfaqet toni urdhërues?

1 pikë

- A) Ty do të dëgjoj.
- B) Me ty dua të plakem.
- C) Pranë tij pra shko.
- D) Fati tim eti të dënoi me vdekje.

17. Ajo çfarë uron Orestit në vargjet e fundit të këtij fragmenti, është:

1 pikë

- A) që të vendoset e drejta në këtë shtëpi.
- B) që shpirti i të vdekurve të prehet në paqe.
- C) që jeta e kësaj shtëpie të mos shuhet.
- D) që kjo shtëpi të mbrohet nga perënditë që këtej e tutje.

18. Në këtë tragjedi konflikti tragjik zhvillohet:

1 pikë

- A) brenda familjes mbretërore.
- B) midis familjes mbretërore dhe qytetarëve.
- C) midis familjes mbretërore dhe perëndive.
- D) midis dy mbretërive fqinje.

19. Gjeni një nga motivet kryesore të tragjedisë në këtë pjesë. Ilustrojeni atë me vargjet përkatëse.

a) motivi: _____

1 pikë

b) ilustrimi: _____

1 pikë

20.

a) Ç'imazh përpiqet të krijojë Klitemnestra për ta ndaluar Orestin që ta vrasë? 1 pikë

b) Identifikoni një argument që ajo përdor, për të justifikuar veten përpara Orestit për krimin e kryer dikur.

1 pikë

21. Portretizimi i Klitemnestrës realizohet përmes ligjërimit të Orestit. Ç'cilësi të karakterit të saj theksohen dhe pse?

3 pikë

22. Gjendja shpirtërore e Orestit para vrasjes shfaqet e dyzuar. Cilat janë arsyet e këtij dyzimi? Mbështeteni mendimin tuaj me nga një ilustrim për secilin rast.

a) arsyet: _____

2 pikë

b) ilustrimet: _____

2 pikë

23. Cila është e veçanta e ndërtimit të këtij vargu: “E kobshnja ëndërr e vërtetë po del”? Shpjegoni arsyen e këtij përdorimi.

2 pikë

a) _____

b) _____

24. Fjala *Fati* përsëritet disa herë gjatë dialogut. Shpjegoni se si shfaqet mendësia e grekëve të lashtë në lidhje me fatin, përmes kësaj vepre të tragjedianit të madh.

2 pikë

